



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Kancelaria Premijera-Office of the Prime Minister
Zyra e Komisionerit për Gjuhët / Kancelaria Poverenika za jezike/ Office of the Language Commissioner

ZYRA E KOMISIONERIT PËR GJUHËT shpallë të lirë këtë vend të punës:

1. Një(1) Zyrtar i lartë për zhvillimin e Kapaciteteve

Numri i referencës: ZKM-ZKGJ-006

Koeficienti: 8

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e Koordinatorit për Sigurimin e Zbatueshmerisë kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- **Këshillimi** i institucioneve nën juridiksionin e Zyrës lidhur me planifikimin, vlerësimin, përcaktimin dhe alokimin e resurseve adekuate buxhetore për implementimin e Ligjit dhe politikave tjera relevante për përdorimin e gjuhëve, dhe informon publikun e përgjithshëm dhe komunitetet gjuhësore mbi masat dhe resurset e nevojshme për këtë qëllim.
- **Mbështetja** institucioneve nën juridiksionin e Zyrës për të rekrutuar, alokuar dhe trajnuar resurset adekuate njerëzore për implementimin e Ligjit dhe politikave tjera relevante për përdorimin e gjuhës. Informon publikun e përgjithshëm dhe komunitetet gjuhësore mbi masat dhe resurset e nevojshme për këtë qëllim.
- **Këshillimi** i institucioneve nën juridiksionin e Zyrës lidhur me rekrutimin, trajnimin, zhvillimin profesional dhe stimulimet e një numri adekuat të stafit të specializuar në ofrimin e shërbimeve profesionale të përkthimit.
- **Bashkëpunimi me** institucionet nën juridiksionin e Zyrës dhe autoritetet relevante të arsimit dhe shërbimit civil për të iniciuar krijimin dhe implementimin e plan programit para universitar dhe universitar për shkollat dhe universitetet ku juristët linguistë dhe përkthyesit profesional trajnohen formalisht dhe certifikohen për të ushtruar profesionin e tyre.;
- **Bashkërendimi me** institucionet nën juridiksionin e Zyrës dhe autoriteteve relevante arsimore dhe të shërbimit civil për të siguruar krijimin dhe zbatimin e trajnimeve gjatë shërbimit të përkthyesve të cilët punojnë në administratën publike dhe institucionet tjera nën juridiksionin e Zyrës;
- **Këshillimi** i institucioneve nën juridiksionin e Zyrës dhe autoritetet e shërbimit civil për krijimin dhe zbatimin e sistemeve dhe procedurave për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë dhe saktësisë së shërbimeve të përkthimit
- **Këshillimi dhe asistimi** i autoriteteve arsimore, administratës publike dhe institucioneve tjera nën juridiksionin e Zyrës lidhur me zhvillimin dhe implementimin e plan programeve dhe lëndëve mësimore që ofrojnë mundësi për mësim nxënie të dyja gjuhëve zyrtare, dhe gjuhëve tjera të komuniteteve, për një numër të mjaftueshëm të studentëve dhe shërbyesve të ardhshëm civil.
- **Udhëheqë** institucionet nën juridiksionin e Zyrës, për të zhvilluar dhe zbatuar sistemet për vlerësimin e numrit dhe kapacitetit të stafit me aftësitë gjuhësore në të gjitha gjuhët zyrtare, apo gjuhët zyrtare komunale, aty ku janë të zbatueshme. Asiston institucionet relevante arsimore dhe administrative për të krijuar, zbatuar dhe ofruar në mënyrë të vazhdueshme trajnime gjatë shërbimit, kurse profesionale, stimulime për të fuqizuar aftësitë gjuhësore në të gjitha gjuhët zyrtare apo gjuhët zyrtare komunale, për tërë stafin i cili kryen funksione dhe shërbime publike

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- ✓ Diplomë Universitare në Shkenca Shoqërore; (BA)
- ✓ **Kërkohej 3 vite përvojë pune** në shërbimin civil, sistemin arsimor apo organizatat ndërkombëtare në funksionet që kanë të bëjnë me resurse humane, buxhet, shërbime përkthimi, edukimi apo trajnimi.
- ✓ Njohuri me legjislacion për përdorimin e gjuhëve dhe përvojë e dëshmuar në zbatimin dhe aplikimin e legjislacionit dhe politikave që kanë të bëjnë me ligjin për përdorimin e gjuhëve.
- ✓ Përvojë direkte e dëshmuar në zhvillimin e projekteve dhe menaxhim, dhe në një prej fushave në vijim: menaxhim buxheti; resurse njerëzore; trajnime; shërbime përkthimi.
- ✓ Aftësi të dëshmuara për të krijuar marrëdhënie të shkëlqyera pune me partnerë të ndryshëm dhe institucione;
- ✓ Aftësi të shkëlqyeshme analitike;
- ✓ Aftësi të shkëlqyera të komunikimit me gojë dhe me shkrim dhe aftësitë të dëshmuara në raportim/analiza;
- ✓ Njohuri pune në të dy gjuhët zyrtare esenciale
- ✓ Njohuri pune të paktën në një gjuhë të komunitetit dhe atë Angleze(e preferuar)
- ✓ Njohuri pune në programet Word / Excel etj.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Zyra e Kryeministrit/Zyra e Komisionerit për Gjuhët ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, Dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale, Dëshminë e përvojës së punës, dy referenca.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (rruga Nëna Terezë p.n.). Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen : <http://www.rks-gov.net/pm/> ; <http://www.kryeministri-ks.net/zck/>

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në Zyrën e personelit, Ndërtesa e Qeverisë, kati i IV, zyra nr. 406.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Kohëzgjatja e emërimit sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese 1 vjeçare.

Afati i konkurrimit është prej datës 07/04/2014 deri me datë 21/04/2014, deri në orën 16:00.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 14 818 dhe 038 200 14 817.